



**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK**

**TREGUESIT STATISTIKORE DHE FINANCIARE TE**  
**TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

**Viti 2011**

**TELEFONI CELULARE**

**TELEFONI FIKSE**

**INTERNET**

**Prill 2012**

<b>I. HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>II. PANORAME E PERGJITHSHME</b> .....	<b>4</b>
<b>III. TELEFONIA CELULARE</b> .....	<b>11</b>
III.1 Struktura e perdoruesve dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare.....	11
III.2 Trafiku telefonik .....	17
III.3 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare .....	19
<b>Sherbime te reja: 3G</b> .....	20
<b>IV. TELEFONIA FIKSE</b> .....	<b>22</b>
IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut.....	22
IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom .....	25
<b>V. INTERNETI</b> .....	<b>26</b>
V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre .....	26
V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura.....	28

Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2011.....	5
Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2011.....	6
Figura 3. Krahasimi i normave te penetrimit: Shqiperi vs mesatare e BE- 27 .....	7
Figura 4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2011) .....	8
Figura 5: Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2011).....	8
Figura 6: Pjeset e tregut ne te ardhura te operatoreve alternative ne tregun e komunikimeve elektronike per vitin 2011.....	9
Tabela 1: Investimet e operatoreve te komunikimeve elektronike (2011).....	9
Figura 7: Shperndarja e te punesuarve ne sektorine e komunikimeve elektronike 2011 .....	10
Tabela 2: Numri i te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike (2011) .....	10
Figura 8. Ecuria e numrit të pajtimtarëve celularë 2000-2011 .....	12
Figura 9: Struktura e perdoruesve te telefonise celulare 2011 .....	13
Tabela 3: Detajimi i pajtimtareve celulare 2011 .....	13
Figura 10 : Te ardhurat dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare (2011).....	14
Figura 11: Te ardhurat e operatoreve celulare 2003-2011 .....	14
Figura 12: Pjeset e tregut te operatoreve celulare per te ardhurat ne “retail” per 2011 .....	15
Figura 13: Pjeset e tregut te operatoreve celulare (2011) .....	16
Tabela 4: Pjeset e tregut te operatoreve celulare 2009-2011.....	17
Figura 14: Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2010-2011 .....	18
Figura 15: Trafiku hyres celular sipas origjines 2010-2011 .....	18
Tabele 5: Përdorimi i shërbimeve celulare 2010-2011 .....	19
Tabela 6: Sherbime roaming nderkombetar 2010 dhe 2011 .....	20
Tabela 7: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2011) .....	21
Figura 16. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2011.....	22
Tabela 8: Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse (2010-2011).....	23
Figura 17: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2011) .....	23
Figura 18: Struktura e trafikut dales te Albtelecom 2010-2011.....	24
Figura 19: Struktura e trafikut hyres te Albtelecom 2010-2011 .....	24
Tabela 9: Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2008-2011.....	25
Tabela 10: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2010-2011) .....	26
Figura 20: Pjeset e tregut per akses broadband (2010-2011).....	27
Tabela 11. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2011.....	28
Tabela 12. Te dhena per infrastrukturen e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2011 .....	29

## **I.HYRJE**

AKEP, me qellim informimin e publikut, paleve te interesuara dhe te sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike me treguesit kryesore te ketij tregu, ne vijimesi te raporteve periodike te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) ne seksionin Statistika, ka pergatitur kete raport ne te cilin publikohen treguesit kryesore te tregut per vitin 2011 dhe ndryshimet me periudhat e meparshme.

Ky raport eshte pergatitur duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare, Albtelecom si dhe te dhenave te Operatoreve Alternative dhe Ofruesve te sherbimeve, sipas formuleve te Rregullores te te dhenave statistikore, te plotesuar nga sipermarresit e autorizuar nga AKEP. Per shkak te ruajtjes se konfidencialitetit te te dhenave, jo te gjithe treguesit e raportuar nga operatoret publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyre periodike dhe mund te pasurohet edhe me tregues te tjere apo informacion me te plote per operatoret alternative.

## II. PANORAME E PERGJITHSHME

Numri i sipërmarrësve të regjistruar për ofrim rrjetesh apo shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2011, ka qenë pothuajse i njëjta me atë të vitit 2010. Referuar “Regjistrin të Sipërmarrësve” numri i sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2011 ishte 202 në krahasim me 196 deri në fundvitin 2010 dhe përkatesisht:

- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës, i njëjtë me vitin 2010;
- Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm) – 79 sipërmarrës, kundrejt 82 në vitin 2010;
- Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 130 sipërmarrës, kundrejt 116 në vitin 2010;
- Ofrim shërbimi me vlerë të shtuar – 48 sipërmarrës, kundrejt 43 në vitin 2010;
- Ofrim të linjave me qera – 30 sipërmarrës, kundrejt 37 në vitin 2010.

Gjatë vitit 2011, janë regjistruar 35 sipërmarrës të rinj, ndërsa 17 sipërmarrës kanë kërkuar mbylljen e të gjitha rrjeteve dhe shërbimeve.

Gjithashtu, kanë njoftuar mbyllje të një ose disa shërbimeve 36 sipërmarrës kryesisht shërbimin e transmetimit të të dhenave.

Me qëllim lehtësimin e procedurave dhe rritjen e transparencës në trajtimin e njoftimit dhe konfirmimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nga subjektet, gjatë vitit 2011, AKEP ka punuar në hartimin e një rregullore të re “Për Autorizimin e Pergjithshëm”, duke e shoqëruar me aplikacionin përkatës on-line.

Gjatë vitit 2011, tregu i komunikimeve elektronike vazhdoi të rritet në tre segmentet e tij: telefoninë e lëvizshme, fikse dhe të Internetit.

Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 5.2 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%<sup>1</sup>, një shifer e cila është shumë më e lartë se niveli prej 140% në vitin 2010<sup>2</sup> apo niveli mesatar në vendet e BE prej 124% në 2010. Siç është shpjeguar në shënim numri i pajtimtarëve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfondon para aftit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë nëse do të referoheshim numrit të pajtimtarëve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (aktivë), numri i pajtimtarëve celularë në fund të vitit 2011 do të ishte 3,108,087 (norma e penetrimit 110%) krahasuar me 3,157,404 në fund të 2010. AKEP

<sup>1</sup> Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.


<sup>2</sup> Në këtë vlerësim, shifra e përdorur për popullsinë për vitin 2011 është rezultati paraprak i Census 2011 i publikuar nga Instat: 2,831,741. Treguesit e penetrimit (përdorimi në bazë të popullsisë) janë më të lartë se çdo të ishin po të përdorej numri i popullsisë sipas parashikimeve të mëparshme.

gjykon se ndryshimi në vlerat e cituara më sipër ndodh për shkak se në shifrën numrit të kartave SIM referuar më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri, si edhe një numër pajtimtarësh që mund të mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive.


Numri i pajtimtareve të telefonisë fikse në fund të vitit 2011, rezulton të ketë rritje me rreth 7000 pajtimtare, duke e çuar normën e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri në 12% krahasuar me 10% në vitin 2010. Megjithatë ky nivel është ende i ulët krahasuar me vendet e BE dhe vendet e rajonit.

Gjatë vitit 2011, janë vënë re dhe disa ndryshime cilësore dhe reduktime të tarifave në ofrimin e aksesit broadband në Internet: rritje e penetrimit, rritje e shpejtësisë së aksesit në Internet, reduktim i tarifave, si dhe rritje e konektivitetit ndërkombëtar.

**Figura 1. Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2011**



**Figura 2. Ecuria e penetrimit<sup>3</sup> të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2011**




Sipas të dhënave vitit 2011, nga Altelecom dhe operatorët alternative, të dhënave të Vodafone dhe AMC për numrin e pajtimtarëve me akses në broadband 3G (me kartë USB/modem) si dhe vlerësimeve të AKEP, rezultojnë se numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 161 mijë apo afërsisht 22% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 13.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i lidhjeve me akses broadband (fiks dhe 3G-USB/modem) për 100 banorë është rreth 6.2 %, krahasuar me 3.7 % që ishte në fund të vitit 2010.

Grafiku i mëposhtëm jep në mënyrë krahasimore normat e penetrimit në Shqipëri të shërbimeve të telefonisë fikse, celulare dhe aksesit broadband me vendet e BE.

<sup>3</sup> Per periudhën 2003-2010, numri i banorëve në Shqipëri i referohet të dhënave të Instat për numrin e popullsisë (projeksionet e REPOBA), ndërsa për vitin 2011, sipas të dhënave paraqitura të publikuara nga Instat për Census 2011.

**Figura 3. Krahasimi i normave te penetrimit: Shqiperi vs mesatare e BE- 27**



### Tregues Financiare


Të ardhurat totale të sipërmarrësve ne tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2011 ishin 51922 milion lek te cilat perbejne nje reduktim prej rreth 9 % ne krahasim me vitin 2010 kur te ardhurat ishin 57087 milion LEK. Ky reduktim i te ardhurave eshte ne tendence te kundert me volumin e sherbimeve te cilat jane rritur ndjeshem gjate vitit 2011 (Internet dhe telefoni celulare).

Reduktimi i te ardhurave te sektorit rezulton te jete kryesisht si pasoje e reduktimit te te ardhurave te operatoreve celulare gjate vitit 2011, te ardhura te cilat ishin 39.2 miliard leke, qe perben nje reduktim prej 7% ne krahasim me vitin 2010, kur te ardhurat ishin 41.9 miliard leke. Nderkohe renie ne te ardhura kane pasur edhe Albtelcom dhe operoret alternative ne total.


Peshen kryesore te te ardhurave te sektorit edhe per vitin 2011 vazhdojne ta mbajne operoret celulare dhe Albtelcom, te cilet se bashku zoterojne rreth 93 % te të ardhurave të gjithë sektorit , ndersa operoret e tjere (Operoret Alternative) zoterojne rreth 7 % pjese tregu (renie nga niveli 8% ne 2010). Të ardhurat e operatorëve celulare përbëjnë rreth 75% të të ardhurave të të gjithë tregut (rritje nga 73 % e 2010 per te njejet tregues te krahasuar), ndërsa operatori fiks Albtelcom zotëron 18% te te ardhurave te sektorit (nje renie e vogel prej rreth 1 pike perqindje ne krahasim me 2010).

Sipërmarresit alternative nder me kryesoret sipas te ardhurave mund te vleresohen operatorët Abcom, Primo ASC, Abissnet, Nisatel dhe Info Telecom të cilët së bashku zene rreth 5 % të të ardhurave të sektorit, apo rreth 80 % të peshes totale te te ardhurave te operatorëve alternative.

**Figura 4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2011)**




**Figura 5: Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2011)**





**Figura 6: Pjeset e tregut ne te ardhura te operatoreve alternative ne tregun e komunikimeve elektronike per vitin 2011**



## Investimet

Per sa i perket investimeve te kryera ne vitin 2011, tabela e meposhteme paraqet te dhenat sipas deklarimeve te operatoreve. Ritje te ndjeshme ne krahasim me 2010 paraqesin investimet ne rrjete fikse dhe fibrat optike per rrjete backbone.

**Tabela 1: Investimet e operatoreve te komunikimeve elektronike (2011)**

	2010	2011
<b>Investime ne infrastrukture te rrjetet fikse:</b>	<b>1,820</b>	<b>3,254</b>
Rrjet telefonik PSTN/ISDN	524	427
Rrjet IP (ISP), platforma IP	222	1,434
<b>Infrastrukture rrjet backbone FIBER OPTIKE</b>	<b>1,074</b>	<b>1,393</b>
<b>Investime ne infrastrukture rrjeti celulare</b>	<b>8,089</b>	<b>6,831</b>
<b>Total</b>	<b>9,909</b>	<b>10,085</b>

## Te punesuar

Numri i te punesuarve me kohe te plote nga sipermrresit e komunikimeve elektronike ne vitin 2011 ishte 4166 qe perben nje renie te vogel ne krahasim me 2010 (4240). Shperndarja sipas gjinise tregon se ne vitin 2011 45 % e te punesuarve ishin femra. Sipermarresi me numrin me te madh te te punesuarve eshte Albtelcom me 36 % te te gjithe te punesuarve ne tere sektorin.

**Figura 7: Shperndarja e te punesuarve ne sektorine e komunikimeve elektronike 2011**




Tabela e meposhteme paraqet numrin e te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike ne fund te vitit 2011.

**Tabela 2: Numri i te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike (2011)**

	Operatore Celulare	Albtelcom	Operatore Alternative	Total
<b>Te punesuar me kohe te plote</b>	1700	1491	975	4166
<b>Prej te cileve femra</b>	941	597	314	1852

### III. TELEFONIA CELULARE

#### III.1 Struktura e përdoruesve dhe pjesët e tregut të operatorëve celularë

Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 5.2 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%<sup>4</sup>, një shifer e cila është shumë më e lartë se niveli prej 140% në vitin 2010 apo niveli mesatar në vendet e BE prej 124% në 2010. Sic është shpjeguar në shënim numri i pajtimtarëve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para aftit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë nëse do të referoheshim numrit të pajtimtarëve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (aktivë), numri i pajtimtarëve celularë në fund të vitit 2011 do të ishte 3,108,087 (norma e penetrimit 110%) krahasuar me 3,157,404 në fund të 2010. AKEP gjykon se ndryshimi në vlerat e cituara më sipër ndodh për shkak se në shifrën numrit të kartave SIM referuar më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri, si edhe një numër pajtimtarësh që mund të mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive. Megjithatë në referencat tjera në këtë analizë, AKEP i referohet numrit të kartave SIM aktive si numri i pajtimtarëve celularë, pasi kjo është praktikë që ndiqet edhe në vendet e tjera.<sup>6</sup>

Norma vjetore e rritjes së numrit të përdoruesve ishte rreth 15% (rreth 690 mijë përdorues më shumë), që është më e lartë se norma vjetore e rritjes prej 9% në vitin 2010. Gjatë vitit 2011 rritje më të madhe ka pasur operatori më i ri në treg Plus Communication me rreth 370 mijë pajtimtarë më shumë se 2010, i pasuar nga Eagle Mobile me rreth 290 mijë apo 35% rritje dhe Vodafone me 8% rritje vjetore. AMC operatori më i madh në treg për sa i përket numrit të pajtimtarëve ka pasur reduktim me 5% të tyre. Përdoruesit me parapagim vazhdojnë të përbëjnë më shumë se 90% të përdoruesve celularë dhe kjo strukturë abonentësh është e ngjashme në të katër operatorët.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve celularë sipas operatorëve në periudhën 2000-2011


---

<sup>4</sup> Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

<sup>5</sup> Në këtë vlerësim, shifra e përdorur për popullsinë për vitin 2011 është rezultati paraprak i Census 2011 i publikuar nga Instat: 2,831,741. Treguesit e penetrimit (përdorimi në bazë të popullsisë) janë më të lartë se cdo të ishin po të përdorej numri i popullsisë sipas parashikimeve të mëparshme.

<sup>6</sup> Mali i Zi ka normë penetrimi të telefonisë celule afërsisht 200%, e cila i dedikohet numrit të lartë të vizitorve/turistëve në raport me popullsinë rezidente të këtij vendi.

**Figura 8. Ecuria e numrit të pajtimarëve celularë 2000-2011**



*Burimi: Të dhënat periodike të operatorëve.*

### **Struktura e përdoruesve celularë 2011**

Struktura e përdoruesve celularë, në përdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate), vazhdon të jetë e qëndrueshme ndër vite. Në vitin 2011, 91% e pajtimtarëve ishin përdorues me parapagim. Struktura e përdoruesve është e ngjashme për të katër operatorët celularë, megjithatë Eagle Mobile ka rreth 14% të përdoruesve total me kontrate për vitin 2011, në ndryshim nga tre operatorët e tjerë që kanë 6-8% të përdoruesve total me kontrate.

**Figura 9: Struktura e perdoruesve te telefonise celulare 2011**





Tabela e meposhtme paraqet te dhenat statistikore per vitin 2011, mbi numrin e pajtimtareve celulare te detajuar ne pajtimtare Familjare dhe Biznes si dhe perdorues te sherbimeve te internetit sipas aksesit ne 2G dhe 3G, numrin e pajtimtareve qe kane nderruar operator duke perdorur sherbimin e portabilitetit te numrit, si dhe numrin e pajtimtareve qe kane nderruar programet tarifore ne rrjetet celulare per vitin 2011 sipas operatoreve.

**Tabela 3: Detajimi i pajtimtareve celulare 2011**

Detajime per pajtimtaret e telefonise celulare	AMC	VF-AL	EAGLE	PLUS
<b>Numri pajtimtareve te telefonise mobile ne total i detajuar:</b>	<b>1,920,000</b>	<b>1,809,264</b>	<b>1,110,363</b>	<b>396,722</b>
Perdorues familjare	1,804,800	1,767,303	911,493	369,368
Perdorues biznes	115,200	41,961	198,870	27,354
<b>Numri i pajtimtareve qe perdorin rrjetin celulr per akses ne internet me GPRS/EDGE</b>	<b>779,805</b>	<b>267,788</b>	86,492	70,955
<b>Numri pajtimtareve te telefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS ne total:</b>	<b>55,000</b>	<b>228,249</b>		
- nepermjet aparatit te telefonit celular	46,000	<b>202,756</b>		
- nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	9,000	<b>25,493</b>		
<b>Numri i Pajtimtareve qe kane nderruar program tarifor</b>	<b>56,173</b>	<b>139,752</b>	<b>107,505</b>	<b>3,672</b>
<b>Numri i pajtimtareve qe kane nderruar operator (portabilitet numri)</b>	<b>23,703</b>	<b>8561</b>	<b>14,835</b>	<b>12,597</b>

Te ardhurat totale te kater operatoreve celulare gjate vitit 2011 ishin 39.2 miliard leke, qe perben nje reduktim prej 6% ne krahasim me vitin 2010, kur te ardhurat ishin 41.9 miliard leke.

**Figura 10 : Te ardhurat dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare (2011)**




Ne figuren e meposhtme paraqitet tendenca e te ardhurave celulare ne periudhen 2003-2011, ku mund te vihet re se ne vitin 2011 ka pasur nje renie te te ardhurave ne krahasim me vitin e meparshem 2010.

Gjate 2011 renie me te madhe ka pasur AMC me 20% dhe Eagle me 6%. Ndersa Vodafone ka pasur ndryshim te vogel me rritje prej 1%.

Plus, si operatori me i ri ka pasur rritje te madhe me rreth 75 here, por duhet marre ne konsiderate se per vitin 2010 Plus ishte ne treg per vetem 1 muaj.

**Figura 11: Te ardhurat e operatoreve celulare 2003-2011**



Me poshte paraqiten pjeset e tregut ne tregun e pakices “retail” per vitet 2010 dhe 2011. Vodafone dhe Eagle Mobile kane nje rritje te vogel ndersa AMC ka renie me 3 pike perqindje. Plus is operatori me i ri ka kapur 2% pjese tregu.

**Figura 12: Pjeset e tregut te operatoreve celulare per te ardhurat ne “retail” per 2011**





Figura e mëposhtme paraqesin pjesët e tregut për vitin 2011 për disa tregues kryesorë. Nga figurat mund të vëmë re AMC zotëron pjesë tregu më të madhe për numër pajtimtarësh me 37%,n dersi per te ardhurat ze 34% , thirrje dalese 37% dhe SMS 37%, ndërsa Vodafone ka pjesë më të mëdha tregu për volume te ardhurash 52%, ndersa per thirrje dalëse 51% dhe SMS 51 % respektivisht. Eagle Mobile ka arritur në 21% pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve dhe 12% pjese tregu per te ardhurat, 10% pjese tregu per thirrjet dalese dhe SMS, ndërsa Plus rreth 8% per numer pajtimtarësh, 2% ne te ardhura dhe 2% ne SMS.

**Figura 13: Pjeset e tregut te operatoreve celulare (2011)**





Në tabelen e mëposhtme paraqitet ecuria e pjesëve të tregut për 2009-2011 për numër pajtimtarësh, thirrje dalëse, SMS dhe të ardhurat. Nga të dhënat vihet re se pjesët e tregut të AMC janë reduktuar për të katër treguesit, Vodafone ka reduktim në pjesët e tregut të pajtimtarëve dhe ndërsa ka rritje në tre treguesit e tjere. Eagle Mobile ka pasur rritje në treguesit e pajtimtareve dhe të ardhurave dhe rritje në dy treguesit e tjere. Plus kanë rritje të pjesëve të tregut për të katër treguesit.

**Tabela 4: Pjeset e tregut të operatorëve celularë 2009-2011**

		AMC	VODAFONE ALBANIA	EAGLE MOBILE	PLUS COMMUNICATION
<b>Perdorues</b>	2011	37%	34%	21%	8%
	2010	44%	37%	18%	1%
	2009	46%	40%	14%	-
<b>Thirrje dalese</b>	2011	37%	51%	10%	2%
	2010	46%	45%	9%	-
	2009	38%	47%	15%	-
<b>SMS</b>	2011	37%	51%	10%	2 %
	2010	34%	57%	9%	-
	2009	36%	49%	15%	-
<b>Te ardhura</b>	2011	34%	52%	12%	2%
	2010	40%	48%	12%	0%
	2009	42%	49%	9%	-

### III.2 Trafiku telefonik

Trafiku telefonik dales gjate vitit 2011, krahasuar me vitin 2010 vazhdon të ketë trend rrites (me rreth 17%), gjithashtu edhe terminimi i thirrjeve hyrese nga rrjetet e tjera për vitin 2011 ka rritje rreth 13% krahasuar me vitin 2010. Ndërsa rritje të ndjeshme ka edhe numri i SMS-ve dalese për vitin 2011 duke e krahasuar atë me vitin 2010 (rreth 58%).

Duke e vlerësuar rritjen e trafikut dales drejt rrjeteve fikse dhe celulare kombëtare, dhe trafikun dales ndërkombëtar, rezultojnë që për secilin nga drejtimet e mësipërme rritja respektive në % ka rritje dhe konkretisht trafiku dales brenda rrjetit për 2011 krahasuar me 2010 ka një rritje prej rreth 18%, trafiku dales drejt rrjeteve fikse ka një rritje prej rreth 15%, ndërsa trafiku dales drejt rrjeteve të tjera celulare (off-net) një rritje të vogël rreth 5% si dhe trafiku dales ndërkombëtar ka një rritje të vogël rreth 1%.

Përsëri vihet re se pesha e trafikut dales brenda rrjetit edhe për vitin 2011 vazhdon të ketë rritje (18%), dhe në totalin e trafikut dales (thirrjet on-net) për të katër operatorët celularë zënë mbi 90 %.

**Figura 14: Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2010-2011**





Fig.16, pasqyron trafikun telefonik hyres ne rrjetet e operatoreve celulare i detajuar sipas origjines se thirrjeve: nga rrjete te tjera celulare, rrjete fikse dhe nderkombetare.

**Figura 15: Trafiku hyres celular sipas origjines 2010-2011**



### III.3 Perdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Ne vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mujor për përdorues celularë. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Këta tregues janë llogaritur për të gjithë trafikun e gjeneruar dhe marrë gjatë periudhës pjestuar me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës (mesatarja e numrit të përdoruesve në fillim dhe në fund të periudhës). Thirrjet dalëse përfshijnë gjithë trafikun e origjinaluar nga përdoruesit celularë ndërsa thirrjet hyrëse përfshijnë thirrjet e marra nga përdoruesit, nga rrjetet e tjera dhe nga i njëjti rrjet. Përdorimi mujor i SMS i referohet vetëm mesazheve të dërguar. Në vitin 2011 ka vazhduar tendenca e rritjes së përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike që ka filluar në vitin 2009, megjithatë kjo rritje ka qenë shumë me vogël se rritja e ndjeshme në 2009 dhe 2010. Konsumi mesatar i thirrjeve është rritur me 4-5%, ndërsa përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 21%. Në vitin 2011, një përdorues celular ka kryer mesatarisht 83 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 94 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 177 minuta komunikim në muaj dhe ka dërguar rreth 12 SMS në muaj.

**Tabele 5: Përdorimi i shërbimeve celulare 2010-2011**

	2010	2011	Ndryshimi %
<b>Thirrje dalëse në muaj</b>	80	83	4%
<b>Thirrje të marra (hyrëse) në muaj</b>	90	94	5%
<b>MOU<sup>7</sup></b>	170	177	4%
<b>SMS (dalëse) në muaj</b>	10	12	21%

Rritje më të mëdha të përdorimit të shërbimeve dhe konsum më të madh kanë pajtimtarët e Vodafone, të cilët gjatë vitit 2011 kanë kryer mesatarisht 118 minuta telefonata dalëse në muaj, 257 minuta komunikim telefonik (thirrje dalëse dhe të marra) në muaj dhe 25 SMS të dërguara në muaj, vlera të cilat janë ndjeshëm më të larta se mesatarja e tregut.

Vlerat e raportuara në tabelat e mësipërme janë përlllogaritur mbi bazën e numrit total të pajtimtarëve të matura me kartat SIM aktive. Në vijim të komentit të bërë në hyrje të këtij kapitulli, për diferencën e madhe midis kartave SIM aktive dhe numrit të përdoruesve aktivë celularë, AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më të mëdha<sup>8</sup> pasi një

<sup>7</sup> Minutes Of Use: Minuta përdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse.

<sup>8</sup> Duke përdorur numrin e pajtimtarëve aktive, vlerat e tabelës së përdorimit mesatar për vitin 2011 do të ishin 56% më të larta dhe me vlerat e mëposhtme:

Thirrje dalëse	130
Thirrje hyrëse	147
MOU	277
SMS	19

numër i konsiderueshëm pajtimtarësh janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karka SIM të operatorëve celularë Shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohëshëm apo vizitave në Shqipëri).

Gjate vitit 2011, ka pasur rritje të mëtejshme të konkurrencës midis operatorëve për shërbimet e ofruara, e perforcuar kjo nga implementimi i procesit të bartjes së numrave që filloi në Maj 2011.

**Tabela 6: Shërbime roaming nderkombetar 2010 dhe 2011**

	2010	2011
<b>Numri i pajtimtareve të rrjeteve Shqiptare që kanë përdorur Roaming Nderkombetar</b>	<b>549,703</b>	<b>954,586</b>
<b>Numri i pajtimtareve të rrjeteve të huaja që kanë përdorur Roaming Nderkombetar në Shqipëri</b>	<b>2,703,290</b>	<b>4,243,532</b>

Vihet re që shërbimi roaming për vitin 2011 krahasuar me vitin 2010 ka një rritje të konsiderueshme si për pajtimtarët e rrjeteve shqiptare që përdorin roamingun nderkombetar duke pësuar një rritje rreth 74 % gjithashtu edhe për pajtimtarët e rrjeteve të huaja që përdorin roamingun në Shqipëri me një rritje rreth 57 %. Faktoret e rritjes mund të kenë lidhje si me efektin e levizjes së lire gjithashtu edhe me prezencën e turistëve në sezonin turistik.

### **Sherbimi mesazheve MMS**

Përdorimi i shërbimeve MMS për vitin 2011, është në nivel shumë të kufizuar me rreth 563 mijë MMS të dërguara dhe të marra nga abonentët gjatë 12 muajve, që përben konsum shumë të vogël mujor. Krahasuar me vitin 2010, në të cilin MMS të dërguara dhe të marra rezultojnë rreth 930 mijë, vihet re një rënie e ndjeshme e përdorimit të shërbimit të MMS-së nga pajtimtarët e telefonisë celulare, një rënie rreth 42% krahasuar me 2010.

### **Sherbime të reja: 3G**

Me datë 10 Janar 2011, Vodafone Albania lancoi për herë të parë shërbimet 3G në Shqipëri dhe AMC shumë shpejt pasi mori të drejtën filloi ofrimin e shërbimeve 3G në fund të 2011. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme mund të vihet re se numri i pajtimtareve që përdorin shërbime 3G në të dy rrjetet është rreth 280 mijë.

Njekohesisht perdoruesit me karta modem/USB 3G qe lejon aksesin ne internet nepermjet PC eshte rreth 34 mije qe perben 25% te pajtimtareve total (fiks dhe 3G) me akses broadband ne Shqiperi. Pra ne nje periudhe kohore me pak se nje vit perdorimi i sherbimeve duket se eshte i kenaqshem. Njekohesisht me hyrjen ne treg te AMC eshte vene re edhe reduktim i tarifave per sherbimet 3G.

**Tabela 7: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2011)**

	<b>AMC</b>	<b>VODAFONE</b>	<b>TOTAL</b>
Numri pajtimtareve tetelefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS ne total:	<b>55,000</b>	<b>228,249</b>	<b>283,249</b>
- nepermjet aparatit te telefonit celular	<b>46,000</b>	<b>202,756</b>	<b>248,756</b>
- nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	<b>9,000</b>	<b>25,493</b>	<b>34,493</b>


## IV. TELEFONIA FIKSE

### IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut

Në vitin 2011, telefonia fikse në ndryshim nga vitet e fundit ka shënuar rritje në numrin e pajtimtarëve. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2011, arriti në rreth 339 mijë, nivel i cili përbën një rritje me rreth 7000 pajtimtare apo 2.2% në krahasim me rreth 332 mijë në fund të vitit 2010. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri arriti në 12% krahasuar me 10% në vitin 2010, megjithatë ky nivel është ende shumë i ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit.

Gjatë vitit 2011 numri i pajtimtarëve të Albtelecom është reduktuar (si edhe në 2010) me rreth 19 mijë apo 7% në krahasim me 2010, ndërkohë numri i pajtimtarëve të operatorëve alternativë fiks është rritur me 26 mijë apo 49% krahasuar me vitin 2010.

**Figura 16. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2011**




Albtelecom në fund të vitit 2011, kishte rreth 259 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 80 mijë. Renia e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom dhe rritja e numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternative ka çuar në reduktimin e pjesës së tregut të Albtelecom nga 84% në 2010 në 76% në 2011.

Sipas te dhenave Abcom, ASC, Nisatel, Primo dhe AMC Fiks (qe ka filluar ne Dhjetor 2011 ofrimin e sherbimit te telefonise fikse me numra fiks duke perdorur rrjetin GSM) jane pese operatore alternative me te medhenj qe zoterojne rreth 67% te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse te operatoreve alternative. Abcom dhe ASC kane rritjen me te madhe vjetore me 36% dhe 37% respektivisht, si edhe AMC qe per vetem 1 muaj aktivitet ne ofrimin e sherbimit te telefonise fikse me numra fiks duke perdorur rrjetin GSM ka arritur te kape 2% pjese tregu. Abcom vazhdon te jete operatori me i madh alternativ fiks me rreth 27 mije pajtimtare. Vlen te theksohet se Abcom dhe ASC si dy operatore alternative me te medhenj jane prezent ne treg me oferta 'triple play' duke ofruar Internet broadband, telefoni dhe TV.

**Tabela 8: Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse (2010-2011)**


	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	AMC Fiks	OA te tjere	Total
<b>2010</b>	277,763	19,975	7,408	5,900	3,678		16,778	331,502
<b>2011</b>	258,943	27,167	10,129	4,950	3,300	7,565	26,790	338,844
<b>Ndryshimi</b>	-7%	36%	37%	-16%	-10%		60%	2.21%

**Figura 17: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2011)**




Figurat e meposhteme paraqesin strukturen e thirrjeve dalese te pajtimtareve te Albtelecom dhe thirrjeve hyrese nga rrjetet e tjera ne Albtelecom. Per thirrjet dalese vihet re se thirrjet lokale perbejne nje pjese te konsiderueshme te thirrjeve dalese mbi 80%, ndersa thirrjet nderkombetare dhe drejt rrjeteve celulare perbejne nje pjese shume te vogel me me pak se 10%. Per thirrjet hyrese nga rrjetet e tjera vihet re se thirrjet hyrese nderkombetare jane rreth 50% ndersa thirrjet hyrese nga rrjetet celulare eshte shume e vogel me pak se 10%.

**Figura 18: Struktura e trafikut dales te Albtelecom 2010-2011**



**Figura 19: Struktura e trafikut hyres te Albtelecom 2010-2011**





## IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom

Ne tabelen 9, paraqiten disa tregues konsumi mujor te thirrjeve te perdoruesve te Albtelecom. Perdorimi eshte matur sipas trafikut total dalese dhe hyres (thirrje te marra perfshijne edhe thirrjet brenda rrejtit Albtelecom, lokale dhe kombetare), pjestuar me numrin mesatar vjetor te perdorueve te Albtelecom. Rreshti i fundit parqet totalin e minutave te komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga nje perdorues i Albtelecom, thirrje dalese dhe te marra.

Nga tabela vihet re se konsumi i thirrjeve dalese eshte ne trend zbrites deri ne fund te vitit 2009, por ne vitet 2010 dhe 2011 eshte vene re nje rritje ne thirrjet dalese totale si dhe ne thirrjet e marra (hyrese), e cila reflektohet edhe tek MOU, duke ndryshuar trendin qe ishte ne renie deri ne fund te 2009 dhe per vitin 2011 kemi nje rritje te MOU.

**Tabela 9: Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2008-2011**

	2008	2009	2010	2011
<b>Thirrje dalese<sup>9</sup></b>	<b>164</b>	<b>136</b>	<b>151</b>	<b>179</b>
<b>Lokale dalese</b>	136	112	112	135
<b>Mobile</b>	11	10	7	9
<b>Kombetare drejt fiks</b>	9	41	21	21
<b>Nderkombetare</b>	6	5	4	6
<b>Thirrje te marra</b>	<b>191</b>	<b>181</b>	<b>204</b>	<b>207</b>
<b>MOU</b>	<b>355</b>	<b>317</b>	<b>356</b>	<b>386</b>

Mesatarisht konsumi i thirrjeve te kryera eshte 179 minuta ne muaj thirrje dalese si dhe 207 minuta ne muaj thirrje te marra, qe do te thote qe nje perdorues i Albtelecom gjate vitit 2011 ka shpenzuar mesatarisht 386 minuta apo afersisht 6.5 ore ne komunikim me telefon fiks.

<sup>9</sup> Ne thirrjet dalese perfshihen edhe thirrjet drejt numrave te tjere jo-geografike.

## V. INTERNETI

### V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre

Sipas të dhënave të vitit 2011, nga Albtelecom, operatorët alternative, te Vodafone dhe AMC per numrin e pajtimtareve me akses ne broadband 3G (me karta USB/modem) si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton qe numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 161 mijë apo afërsisht 22% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 13.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i lidhjeve me akses broadband (fiks dhe 3G-USB/modem) për 100 banorë është rreth 6.2 %, krahasuar me 3.7 % që ishte në fund të vitit 2010.

Gjatë vitit 2011, rritje të ndjeshme ne lidhjet broadband kane pasur operatorët alternativë dhe dy operatorët celulare Vodafone dhe AMC, ndërsa Albtelecom ka pësuar rënie të numrit të lidhjeve broadband. Nder operatorët alternativë fiks Abcom vazhdon të jete operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 30 mijë ne fund te vitit 2011, që përbën një rritje prej 116% nga viti 2010. Pjesa e tregut e Abcom për aksesin broadband fiks është rritur nga 11% në 2010 në 21% në 2011, dhe është gjithashtu operatori i dytë më i madh për lidhjet broadband fikse dhe celulare me 17% pjesë tregu. Rritje të madhe ka edhe operatori i dytë alteranativ më i madh ASC me 79% duke zënë 7% pjesë tregu për aksesin broadband fiks dhe 6% për broadband fiks dhe celular.




Albtelecom ka pësuar rënie me 15% të numrit të pajtimtarëve broadband. Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve te operatorëve alternativë dhe reduktimi i numrit të pajtimtarëve të Albtelecom ka cuar në reduktim të ndjeshëm të pjesës së tregut të Albtelecom për aksesin broadband fiks: nga 58% në 2010 në 43% në 2011.

Aksesi broadband nga rrjetet celulare duket se ka filluar të japë efektet pozitive pasi Vodafonë që ka rreth 12 muaj në treg dhe AMC me 2 muaj, kanë arritur të kene rreth 34 mijë abonentë broadband me karta USB/modem 3G, që përbejne 20% të numrit total të pajtiomarëve broadband (fiks dhe celularë). Ndërsa numri i pajtimtarëve celularë të këtyre dy operatorëve që përdorin shërbimin e internetit broadband nëpërmjet aparateve telefonike është rreth 280 mijë në fund të vitit 2011.

**Tabela 10: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2010-2011)**

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	Bleta	OA te tjere	AMC	Vodafone	Total
<b>2010</b>	70,597	13,575	5,666	2,600	4,928	3,000	21,351			121,717
<b>2011</b>	60,055	29,321	10,129	2,500	4,381	3,500	29,811	9,000	25,493	174,190
<b>Ndryshimi</b>	-15%	116%	79%	-4%	-11%	17%	40%			43%

**Figura 20: Pjeset e tregut per akses broadband (2010-2011)**



Nga të dhënat e raportuara vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohe rreth 10% e abonenteve ADSL të Albtelecom përfitojnë akses në Internet me MSAN ku lidhja nga centrali telefonik deri në kabinet është me fibër optike dhe më pas me linjë bakri, e cila mund të konsiderohet si FTTN (Fiber To The Node). Albtelecom ka kryer investime të konsiderueshme në NGA duke installuar një numër të konsiderueshëm MSAN për lidhjen e të gjithë abonenteve me në rrjetin NGA/NGN.

Gjatë vitit 2011, janë vënë re ndryshime cilësore dhe reduktime të tarifave në ofrimin e aksesit broadband në Internet.

Shpejtësia me përdorur është rritur nga 1-2Mbps në 2-4Mbps. Rreth 48% e pajtimtareve me akses broadband fikse kanë shpejtësi 2-4 Mbps dhe rreth 14% kanë akses me 4 Mbps. Gjithashtu operatorët kryesorë kanë oferta edhe për shpejtësi më të larta 4-20 Mbps.

**Tabela 11. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2011**

	Alternative	Albtelecom
<b>Shpejtësia e aksesit në Internet</b>	256 kbit/s- 20 Mbit/s	2 Mbit/s-12 Mbit/s
<b>Shpejtësia me e përdorur</b>	1-2 Mbit/s	2 -4 Mbit/s
<b>Numri i pajtimtareve që kanë akses në shërbime të integruara:</b>		
<b>TV, Internet dhe Telefoni</b>	3947	0

## V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Një faktor i rëndësishëm që ndikon në cilësinë dhe tarifat e aksesit broadband për pajtimtarët është edhe lidhja apo konektiviteti i ISP-ve me Internetin global.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna në lidhje me infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët për rrjetet me fibr optike dhe lidhjen me Internetin global (lidhje me botën). Nga të dhënat vihet re se konektiviteti me Internetin Global është rritur nga rreth 14 Gbps në fund të vitit 2010 në rreth 30 Gbps në fund të vitit 2011. Nderkohe me rritje të ndjeshme paraqitet edhe gjatësia e fibër optike të instaluar nga operatorët e cila është me shumë se dyfishuar në 2011 (4689 km) në krahasime me 2010 (2161 km). Shkak i kryesor i këtyre rritjeve pozitive ishte rritja e investimeve në infrastrukturë duke u orientuar drejt fibër optike sic ishte rritja e kapaciteteve nga Albtelecom dhe operatorëve alternativë si ATU që ka instaluar rreth 540 km fibr optike deri në fund të 2011.

Nderkohe numri i Internet kafeve qe marrin akses nga ISP-te, sipas te dhenave te operatoreve eshte rreth 1100 pa ndryshime te ndjeshme me periudhat e meparshme. Megjithate AKEP gjykon se numri i Internet kafeve ne Shqiperi eshte shume me i madh se 1100.

**Tabela 12. Te dhena per infrastrukturen e aksesit ne Internet ne nivel me shumice 2011**

	<b>Alternative</b>	<b>Albtelecom</b>	<b>Total</b>
<b>Konektiviteti me Internetin Global -Lidhje nderkombetare (Gbps)</b>	10	20	30
<b>Fibër Optike e instaluar (gjatesia km)</b>	1822	2837	4659